

Hapet thirrja për aplikim për bursa në programin Mevlana Exchange, për studentët dhe stafin akademik me kohë të plotë për mësimdhënie, për vitin akademik 2020-2021, në universitetin Kocaeli, Turqi

Në kuadër të programit Mevlana Exchange është hapur thirrja për aplikim për bursa shkëmbimi për vitin akademik 2020-2021. Mevlana Exchange Programme është një program i cili mundëson shkëmbimin e studentëve dhe stafit akademik midis Universitetit të Tiranës dhe Universitetit Kocaeli.

<http://mevlana.kocaeli.edu.tr/>

Nivelet e mobilitetit për studentët:

- Bachelor (viti III nuk mund të aplikojë);
- Master (viti II nuk mund të aplikojë);
- Doktoraturë;

Llojet e mobilitetit për stafin:

- Staf akademik me kohë të plotë për mësimdhënie;

Kohëzgjatja e bursave për studentët:

- 4 muaj;

Kohëzgjatja e bursave për stafin akademik:

- 2 javë;

Për t'u njohur me fushat e studimit ju lutem referohuni linkut:

<http://mevlana.kocaeli.edu.tr/Dosyalar/Belgeler/MevlanaAlanKodlari.pdf>

Dokumentacioni për aplikim për studentët:

- Formulari i aplikimit;
- Vërtetim studentit dhe Listë notash (në gjuhën shqipe dhe të përkthyer në mënyrë zyrtare në gjuhën turke/angleze);
- Certifikatë e gjuhës së huaj (anglisht/turqisht);

Dokumentat e nevojshme për aplikim mund të shkarkohen në linkun:

http://mevlana.kocaeli.edu.tr/index_en.php?enpages=page&id=documents

Në momentin e aplikimit duhet të dorëzohen vetëm dokumentacioni i sipërcituar. Të gjithë dokumentet shtesë do të kërkohen në një moment të dytë.

*Studentët paguajnë pagesën e shkollimit në universitetin e vendit të tyre, pra ku ata janë regjistruar dhe nuk paguajnë asnjë pagesë tjetër shkollimi në universitetin pritës.

Dokumentacioni për aplikim për stafin akademik me kohë të plotë:

- CV dhe Lista e publikimeve (në gjuhën angleze/turke);
- Academic Staff Mobility Programme;
- Academic Staff Information Form;

Dokumentat e nevojshme për aplikim mund të shkarkohen në linkun:

http://mevlana.kocaeli.edu.tr/index_en.php?enpages=page&id=documents

Kompensimi financiar për studentët:

- Bursa për studentët është 1300 TL (Turkish Lira) për çdo muaj;
- Biletë udhëtimi (3100 - 4600 TL)

Në momentin e aplikimit duhet të dorëzohen vetëm dokumentacioni i sipërcituar. Të gjithë dokumentet shtesë do të kërkohen në një moment të dytë.

Kompensimi financiar për stafin:

- Kompensim ditor për stafin (45 - 55 TL/ditë);
- Biletë udhëtimi (3100 – 4600 TL)

Afati i aplikimit: 19 Mars 2020

Dokumentat duhen dorëzuar dorazi në Rektoratin e Universitetit të Tiranës, Drejtoria e Marrëdhënieve me Jashtë dhe Studentët, Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë nga e Hëna në të Enjte ora 10:30 – 11:30 dhe 14:30 – 16:00, si dhe duhet të dërgohen të skanuara në e-mailin iro@unitir.edu.al.

Për më shumë informacion mbi bursat mund të na kontaktoni në adresën: iro@unitir.edu.al.

Universiteti i Tiranës ju uron suksese në aplikimin tuaj!